



Datë: 04.10.2024

Drejtoria Komunale për Arsim

Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, Qershor 2088), nenit 47 pika c). Të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr. 98 datë: 30.07.2012, nenit 2, 3 dhe i Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr.83 e datës 14.06.2013, dhe në mbështetje të vendimit me nr. 1920 të datës 04.10.2024, aprovuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 04.10.2024 shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për ndarjen e subvencioneve për transportin e nxënësve në Komunën e Fushë Kosovës

- Të drejtë aplikimi kanë vetëm nxënësit që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës pa kurrfarë dallime etnike, gjinore, fetare dhe politike.

Kategoritë e përfituesve janë :

1. Bartja (transporti) e nxënësve të cilët udhëtojnë në linjat:

- Nakaradë - SHFMU “Selman Riza” Fushë Kosovë
- Lagjja e Ronollëve - SHFMU Laura Scotti” Graboc i Poshtëm
- Harilaq - SHFMU “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe
- Bardh i Vogël - SHFMU “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe
- Harilaq i Vogël - SHFMU “Bajram Curri” Harilaq
- Pomozotin – Shkolla Speciale “Përparimi” Prishtinë

I. Kriteret e përfitimit për transportin e nxënësve:

- Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës
- Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formularin për aplikim (e gjeni në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
- Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;
- Letërnjoftimi i prindit;
- Konfirmimi i xhirrologarisë bankare.

Vërejtje: Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Thirrja mbetet e hapur 15 dite nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve në faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/category/shpalljet/konkurset/>

Konkursi mbetet i hapur nga data 04.10.2024 deri me date 24.10.2024

Drejtori i DKA- së

Fatlum Berisha

